



Planuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivered	06-12-2021	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	It Prot It Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMBAK	5834/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.992/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit A.nr.2898/19 të datës 01.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 4542/2019 të datës 26.09.2019 të parashtruar nga ankuesja

dhe i me adres “Inspektoriat Shëndetësor” në Ministrinë e Shëndetësisë, kundër organit të punësimit-Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ lidhur me ankesën A.nr.583/2019 të datës 26.09.2019 të parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të gjithë Inspektor Shëndetësorë në Ministrinë e Shëndetësisë me datën 11.09.2019 përmesë e-mailit nga u.d.Kryenspektorja iu është shqiptuar vërejtje me shkrim për mos informimin me kohë të u.d kryenspektorit për inspektimin e shërbimit të FAM-it në institucionin e lartë përmendur”.

Ankuesit me datën 18.09.2019 kanë parashtruar ankesën me numër protokolli 05-4980 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë kundër vërejtjes me shkrim e shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Me datën 19.09.2019 janë njoftuar nga udhëheqësi i burimeve njerëzore i Ministrisë së Shëndetësisë se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ankesën duhet ta paraqitni drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesit pas njoftimit të udhëheqësit për burime njerëzore me datë 26.09.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 4542/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.10.2019, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë sipas fletëkthesës e ka pranuar me datën 07.10.2019 por nuk ka dërguar fare përgjigje lidhur me ankesën e ankuesve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 23.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit kanë ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 15.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2898/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 05.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.09.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të datës 26.09.2019 me numër protokollit 4542/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 09.09.2019; Plani i punës 'Janar -31 dhjetor 2019' Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Puna Mujore për shtator 2019; Raporti ditor i datës 09.09.2019 përmes e-mailit zyrtar të datës 09.09.2019; E-mail zyrtar i datës 17.09.2019; Përgjigje në ankesë e datës 19.09.2019; E-mail zyrtar i datës 11.09.2019 për shqiptimin e vërejtjes me shkrim; E-mail zyrtar i datës 27.08.2019; E-mail zyrtar i datës 27.08.2019; E-mail zyrtar i datës 23.09.2019; Aktgjykimit A.nr.2898/19 të datës 01.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe e-mail zyrtar i datës 03.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesve, **është e pa lejuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesve me nr. A.nr.583/2019 të datës 26.09.2019 ka konstatuar se lidhur me ankesën e ankuesve, Këshilli ka pranuar me datën 11.09.2021 janë hjekur vërejtjet nga dosja e ankuesve

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pas e-mailit zyrtar të datës 03.12.2021 nga udhëheqësi i burimeve njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë për heqjen e vërejtjeve nga dosja e ankuesve, andaj mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të vendoset për përfundim të procedimit administrativ, ashtu siç parashihet me nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**.



Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesit Ankuesit dhe të përfundohet procedimi administrativ.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.992/2021, datë 06.12.2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- *Ankuesve;*
- *Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative –gjyqtares Vjollca Limani;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

